



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 289 / 2 Prot.

Gramsh, më 03.02.2020

V E N D I M

Nr. 07, datë 29.01.2020

MBI

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE
PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH.

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës _____.____.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, në mbështetje të ligjit nr.9385,datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, në mbështetje të ligjit nr.9693,datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" i ndryshuar, bazuar në nenin 54 gërma "e" të ligjit nr.139,datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar,bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Ministrisë së Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", në zbatim të VKM-së nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ligjit nr.139,datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 3 gërma "ç", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 23/4, si dhe neni 54 gërma "k" e tij, Këshilli Bashkiak Gramsh :

V E N D O S I :

- 1.Të miratojë në parim dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Gramsh.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë Gramsh.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

ENDRI MEMA

KRYETARI I KËSHILLIT

GRETA LENA

Adresa: Sheshi "Kamber Dërmynshi" Bulevardi "10 Korriku" E-mail: bashkia.gramsh2017@gmail.com

Konceptoi: E.Mema
Miratoi: G.Lena
Konfirmoi: G.Lena